



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 9792 Prot

Tiranë, më 07.6.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE  
DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE  
INTERGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikave 5 dhe 6 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuarm, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, Vendimit nr, 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

**Përgjegjes Sektori, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë.**  
Kategoria B, Kategoria e pagës III- a/1 (një vendë)

**Përgjegjes Sektori, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Morinë.**  
Kategoria B, Kategoria e pagës III- a/1 (një vendë)

**Përshkrim përgjithësues për pozicionin:**

Përgjegjësi i Sektorit të Operacioneve Doganore përgjigjest para Kryetarit të Degës Doganore lidhur me ecurinë e punës në Zyrat Doganore dhe organizon, ndjek punën e tyre në zbatimin e ligjshmërisë në kalimin e mallrave, mjeteve të transportit dhe të udhëtarëve, zbatimin rigoroz të procedurave doganore, si dhe përgjigjet për mbarëvajtjen e punës në të gjithë zyrat doganore me qëllim përmbushjen e misionit doganor.

Organizon punën e punonjësve të zyrave në varësi të tij dhe jep orientimet e duhura me qëllim, kryerjen e punës nga punonjësit e Sektorit në mënyrë korrekte në zbatim të ligjit, shmangien e formaliteteve të panevojshme, vonesave në kryerjen e procedurave doganore ndaj operatorëve ekonomikë, përmirësimin e punës dhe përmbushjen e objektivave;

Organizon punën për përmirësimin e realizimit të procedurave doganore të mallrave, nga momenti i mbërritjes së mjeteve, më pas pranimit, verifikimit dhe kontrollit fizik;

Bashkërendon, mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e kryer nga punonjësit doganorë në varësi si dhe mbart përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin në fuqi apo që i janë deleguar;

Informon në rrugë operative dhe/ose me shkrim, Kryetarin e Doganës për ecurinë e situatës lidhur me detyrat funksionale dhe masat që propozohen apo janë marrë;

Kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në kalimin e mallrave, mjeteve të transportit dhe të udhëtarëve, zbatimin rigoroz të procedurave doganore;

Drejton punën e pikës së peshores dhe pranimit të mjeteve në territorin e doganës;

Kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në fushën e akcizës;

Jep urdhëra dhe udhëzime për punonjësit e varësisë dhe kryen kontrole dokumentare dhe fizike mbi bazen e informacioneve dhe analizës së riskut;

Jep udhëzime për punonjësit e varësisë dhe ndalon kalimin, qarkullimin dhe depozitimin e paligjshëm të mallrave, të mjeteve jashtë zonave doganore dhe pikave të kalimit që janë të ruajtura dhe të miratuara;

Zbaton dhe jep udhëzime për parandalimin dhe zbulimin e kontrabandes dhe çdo trafiku tjetër të paligjshëm;

Lufton shkeljet doganore në çdo moment, duke bashkevepruar me organet e tjera të kontrollit në Degën Doganore, D.P.D dhe agjensi të tjera;

Jep dhe zbaton urdhëra dhe udhëzime lidhur me mbrojtjen të të drejtave të pronësisë intelektuale, (industriale dhe intelektuale, të drejtave të autorit) në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në doganë dhe respektimin e zbatimit të procedurave përkatëse;

Zbaton dhe jep udhëzime lidhur me dispozitat për hyrjen/daljen, lëvizjen e mallrave, mjeteve të transportit dhe të bagazheve, deklaratave doganore, etj.;

Ndjek dhe mbikëqyr mbajtjen nga personeli në varësi të të gjitha regjistrave të duhur, të sekretuar dhe regjistrimit në të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të duhura dhe të sakta sipas akteve ligjore dhe nëligjore në fuqi në fushën doganore;

Zbaton dhe udhëzon punonjësit lidhur me procedurat e klasifikimit, origjinës së mallrave, vlerësimit doganor dhe kontrollit fizik;

Zbaton dhe udhëzon punonjësit lidhur me akcizën, regjimet doganore, magazinimin e përkohshëm, përjashtimet, furnizimet dhe pajisjet për përdorim në bord të mjeteve të transportit, për ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e mallrave me karakter fito-sanitar;

Zbaton dhe jep udhëzime për punonjësit e varësisë për dispozitat për ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e mallrave;

ep urdhëra dhe udhëzime për veprimet e doganierëve gjatë operimit, përshtatjen e operimit në doganë me kërkesat ligjore mundësitë dhe burimet njerëzore si dhe orarin e operimit;

Jep udhëzime për punonjësit e varësisë për zbatimin e urdherave dhe vendimeve kryesisht por pa u kufizuar:

- Për organizimin korrekt të funksionaliteteve të sektorit që ai drejton bazuar në aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi.
  - Për trajtimin e rasteve të konstatuara për subjektet dhe mjetet që i janë shmangur kontrollit dhe mbikëqyrjes doganore si dhe pagesës së detyrimeve doganore.
  - Për rastet që dyshohet se janë cenuar të drejtat e pronësisë intelektuale (industriale, intelektuale, të drejtave të autorit) në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në doganë.
  - Për ceshtjet lidhur me borxhin doganor si dhe shlyerjen e borxhit dhe detyrimeve të prapambetura apo rikuperimit me forcë të tij.
  - Për bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin apo shkatërrimin e mallrave sipas legjislacionit në fuqi;
  - Për vjeljen e gjobave dhe të çdo lloji detyrimi tjetër civil të njohur me ligj;
  - Për kufirin e patakshëm, deklarimin e thjeshtuar, kufizimet për mallrat e duhanit dhe alkoolit, deklarimin e parave dhe mallra të falsifikuar dhe pirate;
- Etj.;

Vendos para përgjegjësisë ligjore të gjithë ata subjekte që kryejnë veprime të paligjshme për t'ju shmangur kontrollit doganor ose që kryejnë çdo lloj trafiku të paligjshëm;

Kthen përgjigje subjekteve, agjensive dhe institucioneve të tjera për çështje doganore.

Merr pjesë në komisionet, grupet e punës, task-force, të ngritura për çështje të ndryshme.

Ndjek dhe zbaton planet e punës, grafikët e shërbimit;

Ben vlerësimin periodik të punonjesve në varesi, lidhur me performancën e treguar dhe nivelin e arritjes së objektivit kryesor të punës dhe ja raporton këtë Kryetarit të Degës Doganore;

Përmbush çdo detyrë tjetër të përcaktuar në akte ligjore, nënligjore, akte të DPD, që i ngarkohen këtij pozicioni pune si dhe përmbush detyrat që i ngarkohen nga Kryetari i Degës së Doganës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda fushës së detyrave funksionale, konform ligjit;

Me miratimin e Kryetarit të Degës Doganore ben riorganizimin e punës së punonjesve të turnit pas mbarimit të orari zyrtar për mbylljen e shërbimeve doganore për subjektet tregtare bazuar edhe në veprimtarinë e doganës homologe. Për këtë qëllim doganieret e turnit nën mbikqyrjen dhe kontrollin e vazhdueshëm të Shefit të Operacioneve i bashkohen doganierëve të tjerë të pikës së hyrjes për kontrollin e të gjitha mjeteve automobilistike që hyjnë në territorin doganor shqiptar;

Kontrollon ndjekjen me rigorozitet të kanalit të caktuar (kanalet e zhdoganimit), kriterin e perzgjedhjes, përmbushjen e masave të përcaktuara në mesazhin e profilit të riskut që ka perzgjedhur deklaratën doganore, plotësimin e aktit të kontrollit me informacion të detajuar lidhur me rezultatin e kontrollit mbështetur edhe në kërkesat e kriterit të perzgjedhjes.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

#### **Kriteret minimale:**

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

#### **Kriteret e veçanta:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë Bachelor dhe “Master Shkencor” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Ekonomike, Juridik, Natyrore, Politeknike,
- Të ketë mbi 3 vitë eksperiencë pune në nivelin ekzekutiv në Administratën Doganore.
- Kërkohej Gjuhe e huaj Anglisht, një gjuhë e dytë avantazh

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 12.062021 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

## **Fusha e Njohurive:**

- 1.Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 2.Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.
- 4.Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronesine Industriale”, i ndryshuar: 5. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar: 6. Ligji nr. 8874, datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope” 7. Ligji nr. 9367, datë 07.07.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
8. Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Për miratimin e Rregullores së Brendshme “ Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore:
9. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Genti Gazheli**

